LIGJ
Nr. 125/2012

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN NR. 7928, DATË 27.4.1995 "PËR TATIMIN MBI VLERËN E SHTUAR", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje te neneve 78, 83 pika 1 dhe 155 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 7928, datë 27.4.1995 "Për tatimin mbi vlerën e shtuar", të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

Neni 1

Në nenin 19 "Furnizimet e përjashtuara", në pikën 1, pas numrit "25.9" shtohet numri "25.10".

Neni 2

Pas nenit 25/9 shtohet neni 25/10 me këtë përmbajtje:

"Neni 25/10
Hekuri dhe çimentoja

Furnizimi i hekurit, i klasifikuar në krerët 7213 dhe 7214 të NKM-së dhe çimentos, i klasifikuar në kodet 2523 29 00; 2523 30 00 dhe 2523 90 00 të NKM-së ndaj subjekteve ndërtuese të hidrocentraleve, të cilat, në bazë të marrëveshjes respektive, i përdorin si lëndë të parë për ndërtimin e hidrocentraleve, është furnizim i përjashtuar. Procedura e përjashtimeve, kriteret dhe përcaktimi i llojit e sasisë përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.".

Neni 3

Në nenin 26 "Importimi i mallrave", fjalia e parë e pikës 2.1 zëvendësohet me fjalinë me këtë përmbajtje:

"Për makineritë dhe pajisjet e importuara nga personat e tatueshëm, në kuptim të këtij ligji, në funksion të veprimtarisë së tyre ekonomike, pavarësisht nga lloji i saj, me përjashtim të makinerive dhe pajisjeve të përcaktuara në shkronjat "g" dhe "gj" të nenit 26/1 të këtij ligji, zbatohet skema e shtyrjes së pagesës së TVSH-së deri në 12 muaj.".

Neni 4

Në nenin 26/1 "Furnizimet e përjashtuara në import", pas shkronjës "f" shtohen shkronjat "g", "gj", "h" dhe "i" me këtë përmbajtje:

"g) Importimi i makinerive dhe pajisjeve, në funksion të realizimit të kontratave të investimeve me vlerë në dhe mbi 50 milionë lekë, është furnizim i përjashtuar nga tatimi mbi vlerën e shtuar. Lista e makinerive dhe pajisjeve që janë direkt të lidhura me investimin, procedura e përjashtimeve dhe kriteret përkatëse përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave. Për këto makineri dhe pajisje, të cilat janë

importuar nën skemën e shtyrjes së pagesës së TVSH-së dhe afati i dhënies së autorizimeve nga administrata doganore ose nga Ministri i Financave nuk ka mbaruar deri në datën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, tatimi mbi vlerën e shtuar përjashtohet. Në rastet kur TVSH-ja e shtyrë është paguar, shuma e paguar nuk rimbursohet.

Në rastin e subjekteve, të cilat kanë bërë importim të makinerive dhe pajisjeve, në funksion të realizimit të kontratave të investimeve me vlerë në dhe mbi 50 milionë lekë, nën skemën e shtyrjes së TVSH-së dhe për të cilat ka mbaruar afati i shtyrjes së autorizimit nga administrata doganore apo Ministri i Financave në datën e hyrjes në fuqi të këtij ligji dhe nuk kanë TVSH për rimbursim tek administrata tatimore, u shuhet borxhi doganor.

Në rastin e subjekteve, të cilat kanë bërë importim të makinerive dhe pajisjeve, në funksion të realizimit të kontratave të investimeve me vlerë në dhe mbi 50 milionë lekë, nën skemën e shtyrjes së TVSH-së dhe për të cilat ka mbaruar afati i shtyrjes së autorizimit nga administrata doganore apo Ministri i Financave në datën e hyrjes në fuqi të këtij ligji dhe kanë TVSH për t'u rimbursuar nga administrata tatimore, u shuhet borxhi doganor për TVSH-në e shtyrë, me kusht që të mos pretendojnë shumën e TVSH-së për rimbursim tek administrata tatimore. Procedurat përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

gj) Importimi i makinerive dhe pajisjeve, në funksion të realizimit të kontratave të investimeve në sektorin e përpunimit aktiv dhe të agrobiznesit, në funksion të realizimit të kontratave të investimeve, pavarësisht nga vlera e investimit, është furnizim i përjashtuar nga tatimi mbi vlerën e shtuar.

Kategoritë e operatorëve ekonomikë, që përfshihen në sektorin e përpunimit aktiv dhe të agrobiznesit përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave. Lista e makinerive dhe pajisjeve, që janë direkt të lidhura me investimin, procedura e përjashtimeve dhe kriteret përkatëse përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave. Për këto makineri dhe pajisje, të cilat janë importuar nën skemën e shtyrjes së pagesës së TVSH-së dhe afati i dhënies së autorizimeve nga administrata doganore ose nga Ministri i Financave nuk ka mbaruar deri në datën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, tatimi mbi vlerën e shtuar përjashtohet.

Në rastet kur TVSH-ja e shtyrë është paguar, shuma e paguar nuk rimbursohet.

Në rastin e subjekteve, të cilat kanë bërë importim të makinerive dhe pajisjeve, në funksion të realizimit të kontratave të investimeve në sektorin e përpunimit aktiv dhe të agrobiznesit, nën skemën e shtyrjes së TVSH-së dhe për të cilat ka mbaruar afati i shtyrjes së autorizimit nga administrata doganore apo Ministri i Financave në datën e hyrjes në fuqi të këtij ligji dhe nuk kanë TVSH për t'u rimbursuar nga administrata tatimore, borxhi doganor shuhet.

Në rastin e subjekteve, të cilat kanë bërë importim të makinerive dhe pajisjeve, në funksion të realizimit të kontratave të investimeve në sektorin e përpunimit aktiv dhe të agrobiznesit, nën skemën e shtyrjes së TVSH-së dhe për të cilat ka mbaruar afati i shtyrjes së autorizimit nga administrata doganore apo Ministri i Financave në datën e hyrjes në fuqi të këtij ligji dhe kanë TVSH për t'u rimbursuar nga administrata tatimore, u shuhet borxhi doganor për TVSH-në e shtyrë, me kusht që të mos pretendojnë shumën e TVSH-së për rimbursim tek administrata tatimore. Procedurat përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

h) Importimi i hekurit, i klasifikuar në krerët 7213 dhe 7214 të NKM-së dhe çimentos, e klasifikuar në kodet 2523 29 00, 2523 30 00 dhe 2523 90 00 të NKM-së, të importuar nga subjektet ndërtuese të hidrocentraleve, të cilat, në bazë të marrëveshjeve respektive, i përdorin si lëndë të parë për ndërtimin e hidrocentraleve, është furnizim i përjashtuar nga tatimi mbi vlerën e shtuar. Procedura e përjashtimeve, kriteret dhe përcaktimi i llojit e sasisë përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

i) Importimi i makinerive prodhuese nga subjektet e tatimit mbi të ardhurat personale mbi biznesin e vogël, në funksion të realizimit të aktivitetit të tyre prodhues, është furnizim i përjashtuar. Lista e makinerive prodhuese që janë direkt të lidhura me investimin, procedura e përjashtimeve dhe kriteret përkatëse përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.".

Neni 5

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 20.12.2012

Shpallur me dekretin nr.7914, datë 7.1.2013 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani